

1299
24.12.20

Nr. 11641 Prot.

Tiranë, më 24/12 2020

Drejtuar: **Z. Petrit AHMETI** ✓
Kryetar
Enti Rregullator i Energjisë

Lënda: **Aplikim për çmimin e shitjes së energjisë elektrike me pakicë për vitin 2021**

I Nderuar z. AHMETI


Ju lutem gjeni bashkëngjitur aplikimin e shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal për çmimin e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2021.

Me konsideratë,

Elton SEVRANI

Administrator

FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL



**APLIKIM PËR ÇMIMIN E SHITJES TË
ENERGJISË ELEKTRIKE ME PAKICË PËR
VITIN 2021**

Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a.

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023
Tiranë

PËRMBAJTJA

I.	PËRMBLEDHJE	3
1.1	Vështrim i Përgjithshëm	3
1.2	Përlllogaritja e Kërkesës për të Ardhura.....	6
1.3	Indeksi i ndryshimit vjetor të çmimit të konsumit.....	7
1.4	Kursi i Këmbimit Valutor	8
1.5	Aktivite në përmirësim të treguesve tekniko-ekonomikë të Shoqërisë	8
II.	PARASHIKIMI I KËRKESËS PËR ENERGJI	18
III.	SHPENZIMET PËR BLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE	21
3.1	Shpenzime për blerjen e energjisë për klientë të FSHU.....	21
3.2	Shpenzime për transmetimin, shpërndarjen dhe disbalancat.	22
IV.	PËRLLLOGARITJA E SHPENZIMEVE OPERATIVE (OPEX)	23
4.1	Përmbledhje për shpenzimet operative.....	23
4.2	Shpenzime materiale dhe konsumi.....	24
4.3	Shpenzime për personelin	24
4.4	Penalitete dhe Gjoha.....	24
4.5	Shpenzime për shërbime korporative	24
4.6	Marrëdhënie me Publikun	25
4.7	Shpenzime për Qera.....	25
4.8	Shërbime Postare dhe Komunikimi	25
4.9	Shpenzime të Teknologjisë së Informacionit	25
4.10	Shpenzime Ligjore	25
4.11	Konsulencë dhe Auditim	26
4.12	Shpenzime të tjera.....	26
V.	AMORTIZIMI, MARZHI I APLIKUAR DHE KOSTO E KAPITALIT TË PUNËS	26
5.1	Amortizimi.....	26
5.2	Marzhi.....	26
5.3	Kosto e lejuar e kapitalit të punës	26
5.4	Kompensimi i borxhit të keq	26
VI.	E ARDHURA E KËRKUAR PËR FURNIZUESIN UNIVERSAL	27
VII.	PROPOZIM PËR TARIFË MESATARE TË SHITJES NGA OSHEE	28

I. PËRMBLEDHJE

1.1 Vështrim i Përgjithshëm

Detyrimi ligjor për përlogaritjen e kërkesës për çmimin e shitjes me pakicë për klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal bazohet në ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike” Nr. 43/2015 datë 30.04.2015, “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” si dhe Metodologjisë së Përcatimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë tek Klientët Fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal aprovuar nga ERE më 23.11.2017.

Krijimi i shoqërisë FSHU në 28.03.2018 mundësoi fillimin e ngritjes së strukturave të shoqërisë në mënyrë që të bëhej plotësisht funksionale në zbatim të liçencës së shitjes me pakicë të energjisë për klientët tariforë. Për arsye të fazës përgatitore të organizimit të FSHU por edhe për shkak të procesit të zgjatur të ndarjes së OSHEE në shoqëri bija, FSHU nuk arriti ta bënte atë akoma funksionale ushtrimin e liçencës së marrë gjatë periudhës 2018 – 2019 e cila ju rikthye përkohësisht OSHEE deri në ndarjen përfundimtare të shoqërisë e cila filloi të funksionojë në fillim të vitit 2020.

OSHEE e krijuar në fundit 2014 trashëgoi një shoqëri në prag të falimentimit me një kapital negative prej **71.2 miliard Lekë** dhe një humbje të akumuluar prej **104.2 Miliard Lekë** nga të cilat rreth 31.5 Miliard Lekë u krijuan gjatë periudhës 2013 – 2014 në kohën kur kjo shoqëri ishte në administrim të përkohshëm.

Prej krijimit dhe deri në fund të vitit 2019 OSHEE, vazhdoi të ushtrojë aktivitetin e shitjes me pakicë të energjisë elektrike. Ndryshimet rrënjësore në administrimin e këtij aktiviteti krahas atij të shpërndarjes së energjisë elektrike prej fundvitit 2014, sollën përmirësime dhe suksese të jashtëzakonshme në performancën financiare të OSHEE, e cila brenda një kohe të shkurtër 2015 – 2018 arriti të akumulonte një fitim neto prej rreth 38 miliard Lekë, ndërkohë që prej krijimit të shoqërisë në vitin 2007 dhe deri në fund të vitit 2014 kishte akumuluar vetëm humbje të vazhdueshme për çdo vit për një total prej rreth 104 miliard Lekë.

Me kalimin 100% të aksioneve në pronesi të Shtetit Shqiptar, menaxhimi dhe strategjia e shoqërisë OSHEE janë pjesë e strategjisë kombëtare që Qeveria po ndjek në të gjithë sektorët, përfshirë këtu sektorin energjistik pjesë e të cilit është kjo shoqëri.

Si pjesë e strategjisë së zhvillimit të sektorit Qeveria Shqiptare hartoi platformën e Rimëkëmbjes së Sektorit të Energjisë Elektrike në fillim të vitit 2015, e cila u pasua nga Plani i Konsolidimit Financiar të Sektorit Publik Elektroenergjitik miratuar më 24 Prill 2019, ku fokusi kryesor ishte përmirësimi i treguesve të performancës së OSHEE-s, reduktimi i humbjeve teknike dhe joteknike, rritja e normës së arkëtimit me qëllim krijimin e një shoqërie financiarisht të

qëndrueshme për të garantuar furnizimin e energjisë elektrike konsumatorëve. Në vazhdim të reformave të ndërmara u aprovua në Parlament ligji Nr. 43/2015 “Per Sektorin e Energjise” datë 30.04.2015 i cili ndryshoi tërësisht modelin aktual të tregut të energjisë. Në këtë kuadër krahas punës për përmirësimin e treguesve të përcaktuar në platformë sa më sipër, OSHEE ju kërkua të përgatitet për ndryshimet që lidhen me tregun e liberalizuar të shërbimeve të shitjes dhe shpërndarjes.

Në zbatim të platformës së hartuar nga Qeveria Shqiptare dhe me mbështetjen tërësore të saj OSHEE hartoi një program të detajuar ndërhyrjeje në të gjithë vendin i cili bëri të mundur frenimin e humbjeve të përmirësimin e treguesve ekonomik – financiarë të shoqërisë në një periudhë të shkurtër. Lufta kundër paligjshmërisë, përmirësimi i shërbimeve dhe arkëtimi i detyrimeve të prapambetura janë në qendër të punës së përditëshme për menaxhimin e OSHEE krahas përmirësimit dhe modernizimit të rrjetit.

Duke filluar nga 1 Korrik 2016 OSHEE në rolin e Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe në zbatim të Modelit të Tregut të aprovuar duhet të sigurojë furnizimin e sasisë së konsumuar nga klientët tariforë, për të cilën krahas blerjes së energjisë së prodhuar nga KESH me çmim të rregulluar duhet të blejë gjithë energjinë e prodhuar nga HEC-et private si dhe të blejë diferencën e energjisë në treg.

Viti 2017 ishte një vit i vështirë për gjithë sektorin e energjisë elektrike në Shqipëri për shkak të thatësisë që uli në mënyrë drastike prodhimin vendas të KESH dhe HEC-ve private duke detyruar OSHEE të blejë energji në tregun e lirë me çmim mesatar 8.9 Lekë/Kwh nga 3 Lekë/Kwh që ishte planifikuar. OSHEE shpenzoi 14.2 miliard Lekë më shumë se vlera e planifikuar për blerjen e energjisë elektrike.

Rezultatet e vitit 2018 megjithëse positive nuk arritën tregusit e performancës së planifikuar në fillim të periudhës si rezultat i rritjes së shpenzimeve të blerjes së energjisë, e cila u ndikua nga ndryshimi i strukturës së blerjes dhe rritja e çmimit të blerjes së energjisë elektrike në tregun e lirë. Sasia e prodhuar nga burimet hidrike vendase në vitin 2018 ishte më e madhja e prodhuar ndonjëherë, por kjo rritje u evidentua kryesisht në 6 – mujorin e I-rë i cili ishte shumë i lagësht, ndërsa tremujori i II-të u karakterizua nga thatësi e madhe e cila rriti tej planifikimit importin e energjisë në këtë pjesë të vitit.

Rezultatet e vitit 2019 nuk arritën treguesit e performancës së planifikuar duke rezultuar me një humbje prej **4.17 miliard Lekë**, si rezultat i rritjes së shpenzimeve të blerjes së energjisë, e cila u ndikua nga ndryshimi i strukturës së blerjes. Sasia e furnizuar nga burimet hidrike vendase në vitin 2019 ishte sa 80.15% e sasisë së planifikuar ku sasia e furnizuar nga KESH ishte sa 75.8% e sasisë së planifikuar dhe ajo e furnizuar nga HEC-et private sa 90.7% e sasisë së planifikuar.

Gjatë 2019 shpenzimet për blerje dhe transmetim energjie rezultuan 40 % ose 12 miliard Lekë më të larta se ato të planifikuara në fillim të vitit dhe çmimi mesatar i blerjes së energjisë ishte

5.52 Lekë/Kwh nga 4.13 Lekë/Kwh i planifikuar. Faktorët që ndikuan në rritjen e kostos së blerjes së energjisë ishin:

- *Energjia e furnizuar nga KESH më e ulët se planifikimi*
- *Energjia e furnizuar nga HEC-et private më e ulët se planifikimi*
- *Rritja e konsumit si pasojë e rritjes ekonomike dhe ndryshimit të kushteve të motit*

Ndikimi negativ i rritjes së shpenzimeve të blerjes së energjisë në rezultatin e vitit 2019 u zvogëlua nëpërmjet masave të marra në përmirësim të treguesve ekonomik-financiare, të cilat synojnë:

- ✓ Zvogëlimin e humbjeve jo-teknike nëpërmjet forcimit të kontrolleve në rrjet, ndërprerjes së lidhjeve të paligjshme dhe vendosjes para ligjit të abuzuesve si dhe nëpërmjet investimeve që përmirësojnë teknologjinë dhe organizimin e punës.
- ✓ Zvogëlimin e shpenzimeve operative nëpërmjet masave të marra për kontrollin rigoroz të tyre.
- ✓ Rritjen e arkëtimit nëpërmjet politikave të ristrukturimit të borxhit dhe përmirësimit të marrëdhënieve me klientët duke përmirësuar shërbimin dhe rritur besimin reciprok.
- ✓ Rritjen e efikasitetit të punës së punonjësve të shoqërisë nëpërmjet masave organizative, rritjes së kualifikimit dhe motivimit të punonjësve.
- ✓ Përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike nëpërmjet investimeve në teknologji të përparura që përmirësojnë treguesit teknikë të furnizimit.
- ✓ Zvogëlimin e kohës së ndërprerjeve teknologjike dhe të kohëzgjatjes së riparimit të defekteve në rrjet.

Viti 2020 është viti i parë kur FSHU ushtron aktivitet të pavarur në kuadër të zbatimit të ligjit 43/15 “Për sektorin e Energjisë”, ku ndarja ligjore e shoqërisë u krye në fillim të vitit ndërsa përcaktimet funksionale dhe rregullimi i marrëdhënieve të Grupit OSHEE është duke u finalizuar sipas një Plani Veprimi të detajuar me mbështetje të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Edhe gjatë vitit 2020 si rezultat i thatësisë sasia e energjisë së furnizuar nga KESH pritet të furnizojë me rreth 3,345 Gwh nga 3,950 Gwh që ishte planifikuar duke ndikuar në rritjen e çmimit të energjisë që blihet për konsumatorët tariforë. Megjithatë çmimi i energjisë së blerë në Tregun e Lirë ka shënjuar rënie të ndjeshme e cila ka kompensuar rritjen për shkak të mosfurnizimit nga KESH, kështu çmimi i blerjes së energjisë për klientët e FSHU për 9-mujorin 2020 ishte 3.49 Lekë/Kwh nga 2.94 Lekë/Kwh që ishte planifikuar me një rritje prej rreth 19%.

ERE nuk mori parasysh aplikimin për tarifa dhe çmime të OSSH për vitin 2020 dhe nuk mori asnjë vendim duke lënë në fuqi tarifat dhe çmimet e mëparshme. Lënia në fuqi e këtyre vendimeve në kushtet kur nuk ka një vendim të ERE për tarifë të shpërndarjes në tensionin e ulët 0.4 Kv, bëri që OSSH në mungesë të kësaj tarife, e cila përbën 80% e sasisë së volumit të energjisë së shitur, të zbatojë tarifën mesatare të shërbimit të shpërndarjes sipas vendimit të ERE

Nr. 147. datë 26.12.2014. Zbatimi i tarifës mesatare jo vetëm denatyron vlerën e faturuar të shërbimit të shpërndarjes, por edhe krijon të ardhura të pamërituara për FSHU të cilat nëse do të ishte marrë parasysh aplikimi do të ishin shumë më të ulta dhe ndikimi i faktorëve të mosfurnizimit sipas planit nga KESH për shkak të thatësirës do të ishte i dukshëm.

1.1.1 Statusi Ligjor i Shoqërisë

Në zbatim të ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë” datë 30.04.2015 shoqëria OSHEE ka përfunduar procesin e ndarjes administrative dhe menaxheriale të aktiviteteve të saj në plotësim të kërkesave të ligjit “Për Sektorin e Energjisë” për ndarjen e aktiviteteve të cilat nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen e energjisë elektrike.

Në zbatim të këtij ligji dhe të VKM 244 “ Për miratimin e kushteve për vendosjen e Detyrimit të Shërbimit Publik ndaj të liçensuarve në Sektorin e Energjisë Elektrike...” ERE me vendimet Nr.98 datë 17.06.2016 dhe Nr. 112 datë 08.07.2016 vendosi miratimin e liçencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike dhe përcaktoi FSHU për detyrimin e shërbimit universal.

Për shkaqe objektive në rrethanat e krijuara, FSHU filloi operimin si një shoqëri e pavarur prej datës 01.01.2020, në zbatim të detyrimeve sipas kushteve të përshkruara në liçencën e Shërbimit Universal. Ndarja e plotë funksionale e OSHEE përfshi të drejtat dhe detyrimet, që do ti kalojnë FSHU brënda vitit 2020 sipas planit të detajuar të hartuar, do të plotësojnë përfundimisht ndarjen funksionale të FSHU brënda grupit OSHEE.

1.2 Përlllogaritja e Kërkesës për të Ardhura

Në zbatim të metodologjisë e cila bazohet në përlllogaritjen e të Ardhurave të Kërkuara për vitin 2021 kemi marrë në konsideratë supozimet themelore si vijon:

- i. FSHU në plotësim të nevojave të klientëve blen energji nga KESH sipas çmimit të vendosur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (në rolin e asamblesë së aksionerëve si aksioner i vetëm) dhe diferencën nga Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) si energji të blerë në tregun e lirë dhe furnizuar me të njëjtin çmim.
- ii. Çmimet e blerjes së energjisë për Shërbimit për Furnizuesin Universal janë supozuar 1.5 Lekë/Kwh nga KESH dhe 7.8 Lekë/Kwh nga FTL. Tarifa e transmetimit është supozuar e pandryshuar për 0.75 Lekë/Kwh.
- iii. FTL mund të shesë tek FSHU sasinë e energjisë së mbetur nga prodhimi i HEC-ve private pas plotësimit të sasisë së humbjeve në rrjet nga OSSH me çmim të tregut të lirë pavarësisht çmimit të blerjes.

- iv. Çmimi i energjisë së blerë në Tregun e Lirë bazohet në parashikimin sipas monitorimit të tregut 2021 dhe mund të ndryshojë duke u llogaritur si korrigjim në vitet e ardhshme të përlllogaritjes së çmimit të shitje së energjisë.
- v. Përlllogaritja e kërkesës për energji është bazuar gjithashtu në strukturën aktuale dhe parashikimin për vitin në vazhdim por që në varësi të ndryshimeve të kërkesë së konsumatorëve tariforë mund të jetë gjithashtu objekt i korrigjimeve për diferenca në periudha të tjera.

Sasia e energjisë që do të shitet për konsumatorët tariforë për vitin 2021 parashikohet të jetë 5,128 Gwh.


Shpenzimet Operative janë llogaritur bazuar në shpenzimet e pritshme të vitit 2020 duke marrë parasysh edhe koeficientin inflativ të rritjes së çmimeve. Menaxhmenti i shoqërisë i ka kushtuar rëndësi të madhe kursimit për çdo zë të shpenzimeve megjithatë është ndeshur me nevojën e rritjes të disa prej tyre nga viti në vit për të rritur performancën duke ushtruar një kontroll më të madh në përmirësimin e sistemit të faturimit. Kostot e humbjeve dhe detyrimeve të trashëguara kanë sjellë shpenzime për penalitete që rëndojnë shpenzimet operative të kompanisë, të cilat sipas metodollogjisë nuk janë marrë parasysh në llogaritje.

Llogaritja e borxhit të keq bazuar në metodollogjinë e tarifave miratuar nga ERE është llogaritur duke mesatarizuar të dhënat e pritshme nga arkëtimi i detyrimeve korente për vitin 2021 sipas planit të arkëtimit në Planin e Konsolidimit Financiar miratuar me VKM prej 95%.

Nga përlllogaritjet si më poshtë kërkesa për të ardhura në vitin 2021 në llogaritjen e çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike rezulton të jetë rreth **56.2 miliard Lekë**.

1.3 Indeksi i ndryshimit vjetor të çmimit të konsumit


Referuar të dhënave të Institutit të Statistikave INSTAT janë marrë të dhënat e grafikut të mëposhtëm të cilat tregojnë se indeksi i çmimit të konsumatorit për vitin në vazhdim 2020 tenton të jetë rreth 2%.



Megjithë sa më lart mbështetur në të dhënat shumëvjeçare të Bankës së Shqipërisë si dhe në pritshmërinë e treguesve ekonomikë të Shqipërisë në përlogaritjet për tarifë kemi konsideruar një koeficient inflacioni prej 3%.

1.4 Kursi i Këmbimit Valutor

Sipas të dhënave të mëposhtme të marra nga faqja në internet e Bankës së Shqipërisë për kursin e këmbimit EURO/Lekë 2020 si në grafikun më poshtë dhe tendencës për vitin 2021, kursi i këmbimit për energjinë e importit është marrë 1EURO= 124 Lekë.



1.5 Aktivitete në përmirësim të treguesve tekniko-ekonomikë të Shoqërisë

1.5.1 Treguesit Kryesorë të krahasuar të FSHU gjatë 10 muhorit të vitit 2020

Treguesit kryesorë të performancës së FSHU gjatë 10 muhorit të vitit 2020 krahasuar me buxhetin e aprovuar 2020 paraqiten në tabelën si më poshtë:

000/Lekë	Pershkrimi	Janar-Tetor 2020	Buxheti Janar- Tetor 2020	Diferenca	%
Te ardhurat	Te ardhura nga Shitja e energjisë	45,035,829	45,186,521	↓ (150,692)	100%
	Te ardhur nga kamatevonesat	716,893	777,346	↓ (60,453)	92%
	Te tjera	62,192	8,484	↑ 53,708	733%
	Gjithsej	45,814,914	45,972,351	↓ (157,437)	100%
Shpenzimet	Shpenzime Energji e Blere	13,224,960	11,951,722	↓ 1,273,238	111%
	Tarifa e Shpërndarjes dhe Ener. Reak.	20,123,651	24,614,467	↑ (4,490,816)	82%
	Transmetim dhe Disbalanca	3,072,225	2,908,042	↓ 164,183	106%
	Shpenzime Operative	2,090,975	2,538,957	↑ (447,982)	82%
	Provizione	2,973,602	1,022,961	↓ 1,950,641	291%
	Amortizimi	33,754	34,145	↑ (391)	99%
	Shpenzime Financiare	26,603	86,032	↑ (59,430)	31%
	Tatim Fitimi	994,768	669,617	↓ 325,151	149%
	Gjithsej	42,540,538	43,825,943	↑ (1,285,405)	97%

Treguesit kryesorë të Rezultatit Financiar të FSHU gjatë 10-mujorit të vitit 2020 si më poshtë:

- *Rezultati financiar i 10 mujorit të vitit 2020 ishte një fitim prej 3.2 miliard Lekë.* Tarifat e ulta të shpërndarjes së energjisë në krahasim me ato të planit financiar ishin shkaku kryesor I këtij rezultati që u shoqërua me rritje të kostos së energjisë së blerë , ulje të shpenzimeve operative dhe rritje të provigjoneve.
- *Rritje e shpenzimeve për energjinë blerë:* Gjatë periudhës 10-mujore Janar – Tetor 2020 shpenzimet për energji të blerë u rritën me 1.2 miliard Lekë në krahasim me atë të buxhetuar. KESH shiti tek FSHU 670 Mwh energji elektrike me pak se planifikimi e cila u ble me çmim të tregut të lirë i cili për 10 mujorin 2020 kishte një çmim mesatar prej 6.12 Lekë/kwh nga 1.5 Lekë/kwh që është çmimi i energjisë së blerë nga KESH duke shkaktuar një rritje shpenzimesh prej rreth 3.1 miliard Lekë. Ky efekt negativ u zvogëlua nga ulja e çmimit të blerjes në tregun e lirë e cila ishte planifikuar në blerje për 8.63 Lekë/Kwh.
- *Ulja e shpenzimeve të shpërndarjes:* Shpenzimet e shpërndarjes së energjisë u planifikuan bazuar në aplikimin e FSHU pranë ERE për tarifatat e shpërndarjes së vitit 2020 të cilat nuk u aprovuan duke mbetur në fuqi tarifa mesatare e vitit 2015, e cila solli një kursim prej rreth 4.5 miliard Lekë në këtë zë të shpenzimeve duke përmirësuar rezultatitn financiar të shoqërisë.
- *Të Ardhurat nga Energjia:* Të Ardhurat nga Shitja e Energjisë pritet të jenë thuajse të barabarta me ato të planifikuara rreth 100% me 151 milion Lekë më pak. Për tu theksuar që në kushtet e pandemisë së COVID-19 të ardhurat nga konsumatorët familjarë u rritën 5% ndërkohë që për shkak të kurrjes ekonomike të vendit të ardhurat nga konsumatorët privatë u ulën 8%

- *Të ardhurat nga kamatëvonesat:* Të ardhurat nga kamatëvonesat u ulën 8% në krahasim me ato të buxhetuara.
- *Shpenzimet operative:* Shpenzimet operative të 10-mujorit 2020 kanë një kursim prej 448 milion, por duhet theksuar se një pjesë e shpenzimeve operative akoma nuk janë kontabilizuar në rregjistrin kontabël të FSHU duke mbetur akoma tek OSHEE për shkak të ecurisë së ndarjes së detyrimeve dhe të drejtave nga shoqëria mëmë (OSHEE), e cila pritet të përfundojë brenda vitit 2020.
- Arkëtimet e realizuara për 10-mujorin ishin sa 92.5% e vlerës së faturuar e cila është nga 97.3% që u planifikuan duke shkaktuar një rritje të shpenzimeve prej 1.9 miliard Lekë në krahasim me atë të planifikuar.
- Shpenzimeve financiare lidhet kryesisht me ndryshime në normat e këmbimit për kreditë e trashëguara në monedha të ndryshme.
- OSHEE ka paguar 100% faturat korente ndaj KESH dhe OST, si dhe ka paguar pjesën e detyrimeve të prapambetura ndaj KESH sipas marrveshjes së lidhur.

1.5.2 Paraqitja e aktivitetit të furnizimit me pakicë të energjisë për periudhën deri në Shtator 2020

1. Treguesit mbi numrin e klientëve të shërbyer dhe marrëdhënia kontraktuale

Numri i klientëve aktivë të faturuar në OSHEE-s gjatë 9- mujorit te 2020 ishte 1,273,000 që është rreth 0.7% më i lartë se numri i klientëve aktiv në fund të vitit 2019.

Rritje vërehet në kategorinë familjarë, në të njëjtat vlera të projeksioneve të rritjes së popullsisë përdorur në parashikimin e kërkesës për energji, dhe po ashtu rritje vërehet dhe në kategorinë privatë, buxhetorë dhe jo-buxhetorë.

Peshën më të lartë specifike në numrin e klientëve e mbartin klientët familjarë në masën 86%, duke vijuar me trendin e viteve pararendëse.

Klientët Sipas kategorisë

Kategoria	2016	2017	2018	2019	2020
Buxhetor	8,763	9,010	9,548	9,766	9,911
Jo buxhetor	3,129	3,152	3,233	3,267	3,321
Privatë	147,695	152,219	157,467	162,177	163,753
Familjarë	1,028,994	1,045,577	1,065,029	1,088,770	1,096,015
SHUMA	1,188,581	1,209,958	1,235,277	1,263,980	1,273,000

Numri i Klientëve sipas nivelit të tensionit:

Lloji Tensioni matjes	2016	2017	2018	2019	9M 2020
------------------------------	-------------	-------------	-------------	-------------	----------------

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

FSHU.sh.a

Tension i Mesëm 35Kv	85	89	79	76	14
Tension i Mesëm 20/10/6 kv	369	420	472	632	757
Tension i Mesëm 20/10/6 kv Matje TU	4,883	5,946	6,232	6,386	6,529
Tension i Ulet Jo familjar	154,250	157,926	163,465	168,166	169,685
Tension i Ulet Blloku Familjar	1,028,994	1,045,577	1,065,029	1,088,770	1,096,015
Total	1,188,581	1,209,958	1,235,277	1,263,980	1,273,000

Gjatë periudhës që u mbyll më 09/2020, OSHEE ka instaluar një total prej 79,573 matësa nga të cilët rreth 16% në klientë të rinj dhe 84% në ndryshime matësish, ku peshën më të lartë e mbartin zonat e Tiranës (32% e totalit), Elbasanit (16% e totalit) dhe Shkodrës (14% e totalit).

Lidhjet e reja dhe Matësa te Instaluar gjatë periudhës 09/2020

Muaj/Viti	Njësia	Lidhje të reja me matës	Lidhje të reja total	Ndryshimet e matësave	MATESA TE INSTALUAR 9M 2020
Janar	Nr.	1,837	1,837	9,073	10,910
Shkurt	Nr.	1,464	1,464	10,139	11,603
Mars	Nr.	1,003	1,003	5630	6,633
Prill	Nr.	713	713	4909	5,622
Maj	Nr.	543	543	6,332	6,875
Qershor	Nr.	1,904	1,904	10338	12,242
Korrik	Nr.	1,321	1,321	9,937	11,258
Gusht	Nr.	1897	1897	4,782	6,679
Shtator	Nr.	2238	2238	5,513	7,751
Total	Nr.	12,920	12,920	66,653	79,573

Treguesit më lart, janë realizim në përpjekjet për plotësimin e planeve të punës së OSHEE’së për kthimin në ligjshmëri të veprimtarisë së furnizimit me energji elektrike. Në këto përpjekje OSHEE është mbështetur fuqishëm nga Qeveria Shqiptare dhe institucionet në varësi të saj.

Gjatë periudhës 9/2020 OSHEE ka realizuar rreth 227 mijë kontrolle, rreth 75 mijë ndërprerje të energjisë elektrike

Kontrolle gjatë periudhës 09/2020

Muaj	Njësia	Kontrolle	Ndërprerje energjie	% e Ndërprerjeve
Janar	Nr.	53,275	5,342	10.03%
Shkurt	Nr.	21,013	5,245	24.96%
Mars	Nr.	10,329	2,146	20.78%
Prill	Nr.	20,433	8,273	40.49%
Maj	Nr.	28,086	17,596	62.65%
Qershor	Nr.	28,107	10,850	38.60%
Korrik	Nr.	26,336	11,865	45.05%
Gusht	Nr.	21,562	7,931	36.78%
Shtator	Nr.	18,435	6,210	33.69%
Total	Nr.	227,576	75,458	33.16%

Statusi i Verifikimit	Njësia	Total 9M 2020
Ndalim punonjës OSHEE	Nr.	0
Total	Nr.	0

2. Treguesit mbi sasi të e furnizuara me pakicë të energjisë elektrike

Vëllimi i shitjeve të furnizuara

Vlera e energjisë elektrike në fund të periudhës 9-mujore 2020 arriti në vlerën 50 miliard Lekë (me TVSH). Ky tregues paraqet një rënie të lehtë në masën 1.01 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ose 510 milion lekë më pak. Respektivisht 50.0 miliard Lekë në periudhën 9-mujore 2020 në krahasim me 50.4 miliard Lekë në periudhën 9-mujore 2019.

Vëllimet e Shitjes në Lek 2014-9M 2020 (përfshirë TVSH)

Muaj/Viti	Njësia	2015	2016	2017	2018	2019	9M 2020	9M 2020 vrs 9M 2019
Janar	000 Lek	5,429,180	5,858,960	6,188,833	5,934,330	6,702,396	6,623,443	-1.18%
Shkurt	000 Lek	5,471,713	5,317,092	5,319,702	5,766,630	5,813,085	6,221,209	7.02%
Mars	000 Lek	5,467,483	5,381,949	5,137,827	5,670,315	5,491,121	5,244,497	-4.49%
Prill	000 Lek	4,833,378	4,699,751	4,855,182	4,669,844	5,150,728	5,150,100	-0.01%
Maj	000 Lek	4,403,271	4,707,198	4,664,240	4,724,595	5,071,063	4,884,836	-3.67%
Qershor	000 Lek	4,573,290	4,789,139	4,673,063	4,971,923	5,320,242	5,005,470	-5.92%
Korrik	000 Lek	5,131,751	5,170,237	5,431,700	5,396,671	5,679,494	5,709,835	0.53%
Gusht	000 Lek	5,122,566	5,155,073	5,632,981	5,799,545	6,096,525	5,728,877	-6.03%
Shtator	000 Lek	4,715,605	4,756,845	4,821,766	5,050,090	5,203,266	5,448,951	4.72%
Tetor	000 Lek	4,564,099	4,728,006	4,897,273	4,970,781	5,025,241		-100.00%
Nëntor	000 Lek	4,870,383	5,135,231	5,522,878	5,312,088	5,284,988		-100.00%
Dhjetor	000 Lek	5,747,799	6,306,116	6,329,766	6,616,246	6,242,274		-100.00%
Total	000 Lek	60,330,518	62,005,596	63,475,211	64,883,057	67,080,424	50,017,218	-1.01%

3. Treguesit e arkëtimeve për detyrimet e lindura gjatë vitit 2020

Periudha 9 mujore 2020, u karakterizua nga një rënie e arkëtimeve prej 6.1% ose 3.2 mld lekë më pak se e njëjta periudhë e një viti më parë, e cila është rezultat i pandemisë sidomos pergjate muajve mars –prill. Ne muajt ne vijim patem nje permiresim te pagesave, si rezultat i përshtatjes më të mirë të kushteve të pagesës së akt-marrëveshjeve të detyrimeve të prapambetura si dhe i rritjes së ndërgjegjësimit të kategorive të konsumatorëve, për nevojën e pagesës në kohë të detyrimeve të konsumimit të energjisë elektrike sipas faturave.

Vlera mesatare e arkëtimeve mujore gjatë vitit 2020 ishte 5.4 mld leke. Arkëtimet nga këstet e akt-marrëveshjeve përbëjnë rreth 3.4% të totalit të arkëtimeve gjatë 9-mujorit 2020.

Arkëtimet gjithsej përfaqësojnë arkëtimet për :

- Arkëtimet për faturat e vitit 2020 të cilat për 9 mujorin ishin 38.6 miliard Lekë.
- Arkëtimet për detyrime të prapambetura 2007-2019 rreth 9.9 miliard Lekë.
- Arkëtimet nga kamatë vonesat rreth 657 milion Lekë

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tirane

- Arkëtimet nga këstet e akt-marrëveshjeve rreth 1.6 miliard Lekë.

Arkëtimet Mujore për 2013 deri në 9-mujorin e 2020

Muajt/Viti	Njësia	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Janar	000 lek	2,678,829	3,898,715	6,237,313	5,500,506	5,670,000	6,079,858	6,124,203	5,824,962
Shkurt	000 lek	3,203,142	3,803,400	7,361,546	5,369,530	5,601,988	5,687,049	6,322,886	6,068,493
Mars	000 lek	3,670,407	4,078,872	6,217,910	5,359,217	5,831,491	5,990,434	5,923,357	4,817,723
Prill	000 lek	3,604,305	4,011,620	5,120,272	5,105,759	5,038,018	5,615,429	5,742,354	5,592,125
Maj	000 lek	3,176,144	3,722,527	4,923,611	4,920,953	5,328,851	5,219,627	5,402,251	5,232,335
Qershor	000 lek	2,549,362	3,364,736	4,610,278	4,577,557	4,464,007	4,476,741	4,879,104	5,113,994
Korrik	000 lek	3,223,521	3,497,972	4,884,468	4,741,724	5,132,726	5,221,786	5,682,985	4,849,750
Gusht	000 lek	3,306,363	3,428,280	5,123,593	5,196,623	5,526,253	5,506,297	5,768,661	5,447,002
Shtator	000 lek	3,352,020	4,562,783	5,247,969	4,974,418	5,534,745	5,473,281	5,844,088	5,585,632
Tetor	000 lek	3,212,186	4,098,478	5,101,905	4,814,976	5,205,488	5,480,835	5,570,433	
Nëntor	000 lek	2,979,109	4,368,117	4,570,444	4,477,630	4,731,453	4,788,419	4,582,839	
Dhjetor	000 lek	3,623,452	6,362,897	5,236,407	5,178,311	5,734,469	5,839,033	5,977,569	
Total	000 lek	38,578,840	49,198,397	64,635,716	60,217,204	63,799,489	65,378,789	67,820,730	48,532,016

OSHEE për qëllime të matjes së performancës, llogarit efektivitetin e aktivitetit të arkëtimeve bazuar në treguesin e Normës së arkëtimin e cila përlllogaritet si raport i: Arkëtimeve mujore ndaj Faturimit të muajit pararendës.

Norma arkëtimin, si rezultat i vazhdimin të aksioneve dhe nënshkrimit te skemave të reja të akt-marrëveshjeve, në fund të 9 mujorit 2020 ishte 95.3% kundrejt 97.3% në fund të 9 mujorit 2019.

Norma e Arkëtimin për Faturë deri në 90 ditë

Viti 2015

Segmenti	Njësia	Jan.	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qer.	Korr.	Gusht	Shtat.	Tetor	Nënt.	Dhjetor	2015
Buxhetorë	%	56%	80%	80%	86%	91%	84%	90%	72%	124%	95%	82%	93%	84%
Familjarë	%	79%	80%	90%	86%	85%	89%	91%	88%	89%	91%	85%	95%	87%
Jo- Buxh	%	38%	47%	47%	23%	68%	41%	42%	20%	31%	27%	34%	28%	36%
Privatë	%	85%	84%	88%	83%	89%	97%	93%	90%	88%	100%	90%	99%	91%
Total	%	77%	79%	86%	80%	86%	89%	88%	83%	86%	90%	83%	91%	85%

Viti 2016

Segmenti	Njësia	Jan.	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qer.	Korr.	Gusht	Shtat.	Tetor	Nënt.	Dhjetor	2016
Buxhetorë	%	62%	86%	92%	100%	101%	95%	89%	85%	75%	84%	73%	82%	85%
Familjarë	%	84%	83%	92%	87%	95%	89%	92%	92%	89%	93%	91%	95%	90%
Jo- Buxh	%	26%	26%	35%	22%	30%	27%	26%	18%	18%	17%	16%	23%	23%
Privatë	%	90%	89%	96%	90%	99%	92%	91%	97%	94%	99%	90%	94%	94%
Total	%	81%	82%	90%	85%	92%	86%	87%	88%	85%	89%	83%	89%	86%

Viti 2017

Segmenti	Njësia	Jan.	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qer.	Korr.	Gusht	Shtat.	Tetor	Nënt.	Dhjetor	2017
Buxhetorë	%	73%	72%	118%	83%	90%	88%	89%	78%	80%	91%	78%	70%	83%

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

Familjarë	%	88%	87%	105%	95%	103%	94%	101%	99%	96%	101%	92%	96%	96%
Jo- Buxh	%	36%	33%	73%	56%	37%	31%	25%	48%	42%	48%	37%	58%	43%
Privatë	%	90%	94%	101%	93%	100%	90%	102%	94%	91%	108%	96%	96%	96%
Total	%	84%	84%	102%	90%	95%	87%	94%	92%	89%	99%	88%	91%	91%

Viti 2018

Segmenti	Njesia	Jan.	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qers.	Korr.	Gusht	Shtator	Tetor	Nent.	Dhjetor	2018
Buxhetorë	%	75%	98%	111%	81%	103%	77%	90%	76%	78%	90%	58%	90%	85%
Familjarë	%	94%	89%	101%	96%	105%	101%	99%	98%	92%	104%	94%	100%	97%
Jo-Buxh.	%	37%	48%	67%	54%	72%	35%	75%	63%	47%	47%	45%	71%	55%
Privatë	%	94%	95%	98%	95%	102%	92%	97%	94%	87%	106%	88%	102%	96%
Total	%	89%	89%	99%	91%	102%	91%	96%	93%	86%	100%	85%	98%	93%

Viti 2019

Segmenti	Njesia	Jan.	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qers.	Kor.	Gusht	Shtator	Tetor	Nënt.	Dhjetor	2019
Buxhetorë	%	59%	89%	81%	90%	83%	78%	94%	71%	77%	78%	70%	97%	80%
Familjarë	%	88%	85%	98%	97%	101%	89%	99%	94%	91%	98%	89%	97%	93%
Jo-Buxh.	%	24%	37%	39%	36%	33%	62%	26%	69%	51%	38%	19%	99%	45%
Privatë	%	91%	90%	98%	100%	99%	89%	99%	95%	91%	101%	85%	108%	95%
Total	%	82%	84%	93%	92%	94%	86%	92%	91%	87%	93%	80%	101%	89%

Viti 2020

Segmenti	Njesia	Jan.	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qers.	Kor.	Gusht	Shtator	9M 2020
Buxhetorë	%	56%	94%	59%	125%	82%	83%	79%	75%	79%	80%
Familjarë	%	90%	85%	80%	101%	93%	100%	98%	93%	93%	92%
Jo-Buxh.	%	49%	58%	16%	34%	31%	34%	31%	30%	33%	35%
Privatë	%	92%	90%	77%	114%	110%	97%	86%	93%	94%	93%
Total	%	85%	85%	74%	101%	93%	93%	88%	87%	88%	88%

4. Cilësia e portofolit të debitorëve dhe veprimet e ndërmarra për reduktimin e borxhit të klientëve

Në fund të vitit 2014 OSHEE trashëgoi një portofol detyrimesh të papaguara nga klientët që kanë origjinën që prej viti 2007. Vlera totale e detyrimeve të mbartura përbëhet nga detyrimi për fatura (principal) dhe kamatëvonesa për detyrimet e papaguara që llogaritet në masën 0.1% në ditë deri në një maksimale prej 100% të detyrimit të papaguar.

Detyrimet e prapambetura deri në fund të shtator 2020.

2007-2014	Njesia	Fund 2014	Fund 2015	Fund 2016	Fund 2017	Fund 2018	Fund 2019	Fund 09 2020
Principal	000 lek	67,848,538	54,482,691	51,175,006	48,483,178	44,820,309	43,676,124	42,644,561

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

FSHU.sh.a

Kamatë	000 lek	55,997,732	45,576,901	40,494,045	34,170,998	31,457,360	31,908,755	26,208,158
Total	000 lek	123,846,270	100,059,592	91,669,051	82,654,177	76,277,670	75,584,879	68,852,720

Fatura 2015	Njesia	Fund 2015	Fund 2016	Fund 2017	Fund 2018	Fund 2019	Fund 09 2020
Principal	000 lek	8,174,927	6,191,191	5,874,183	5,252,758	4,880,781	4,710,265
Kamatë	000 lek	949,753	2,935,839	4,690,112	4,946,079	4,806,027	4,434,009
Total	000 lek	9,124,680	9,127,030	10,564,295	10,198,836	9,686,808	9,144,274

Fatura 2016	Njesia	Fund 2016	Fund 2017	Fund 2018	Fund 2019	Fund 09 2020
Principal	000 lek	7,275,128	5,639,739	5,083,415	4,666,048	4,581,886
Kamatë	000 lek	974,201	2,869,761	4,413,335	4,840,238	4,709,062
Total	000 lek	8,249,329	8,509,500	9,496,750	9,506,286	9,290,948

Fatura 2017	Njesia	Fund 2017	Fund 2018	Fund 2019	Fund 09 2020
Principal	000 lek	6,434,916	4,375,802	4,047,741	4,011,144
Kamatë	000 lek	768,739	2,252,098	3,547,072	3,936,132
Total	000 lek	7,203,655	6,627,901	7,594,813	7,947,276

5. Treguesit mbi Produktet e ri-pagesës

Deri më 30 Shtator 2020, janë nënshkruar 468,784 AKM, nga të cilat 437,742 nga debitorë familjarë dhe 31,042 jo-familjarë. Vlera gjithsej e detyrimit në akt-marrëveshje është rreth 51miliard Lekë.

Nr. AKM te lidhura

Kategoria	Tipi	Njesia	Dhjetor 2016	Dhjetor 2017	Dhjetor 2018	Dhjetor 2019	Shtator 2020
FAMILJARE	Familjare 1000	#	9,969	9,969	9,969	9,969	61,962
	Familjare 1200	#	16,333	17,383	18,190	18,190	18,674
	Familjare 1800	#	-	-	-	500	501
	Familjare 2000	#	-	-	-	-	45,895
	Familjare 2500	#	16,692	16,692	16,692	16,692	16,692
	Familjare 4200	#	-	-	-	1,152	1,155
	Me Keste dhe Reduktim Kamate Fund	#	12,547	12,559	12,559	12,559	12,559
	Reduktim Kamate	#	233,559	245,432	256,294	264,348	268,195
	Me Keste	#	11,694	11,694	11,839	11,939	12,109
FAMILJARE Total	#	300,794	313,729	325,543	335,349	437,742	
JO FAMILJARE	Biznes i Vogël 100	#	580	589	630	634	634
	Biznes i Vogël 1000	#	248	248	248	248	248
	Me Keste dhe Reduktim Kamate Fund	#	985	1,830	1,830	1,830	1,830
	Privat Riskedulim	#	105	297	297	297	297
	Reduktim Kamate	#	5,934	7,498	9,090	10,960	12,213
	Me Keste	#	13,412	13,425	14,082	14,597	15,820
JO FAMILJARE	#	21,264	23,887	26,177	28,566	31,042	
Grand Total	#	322,058	337,616	351,720	363,915	468,784	

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

Vlera e Detyrimit ne AKM

Kategoria	Tipi	Njesia	Dhjetor 2016	Dhjetor 2017	Dhjetor 2018	Dhjetor 2019	Shtator 2020
FAMILJARE	Familjare 1000	000 Leke	2,169,917	2,169,917	2,169,917	2,169,917	12,706,941
	Familjare 1200	000 Leke	2,322,236	2,704,936	2,987,644	2,987,644	3,173,285
	Familjare 1800	000 Leke	-	-	-	176,767	176,792
	Familjare 2000	000 Leke	-	-	-	-	8,578,038
	Familjare 2500	000 Leke	3,976,936	3,976,936	3,976,936	3,976,936	3,976,936
	Familjare 4200	000 Leke	-	-	-	394,123	395,262
	Me Keste dhe Reduktim Kamate Fund	000 Leke	410,434	414,561	414,561	414,561	414,561
	Reduktim Kamate	000 Leke	10,543,484	11,735,099	12,729,321	12,995,420	13,362,109
	Me Keste	000 Leke	1,057,871	1,057,871	1,072,847	1,085,640	1,099,530
	FAMILJARE Total		000 Leke	20,480,880	22,059,321	23,351,226	24,201,009
JO FAMILJARE	Biznes i Vogel 100	000 Leke	58	59	67	0	
	Biznes i Vogel 1000	000 Leke	308	308	308	308	308
	Me Keste dhe Reduktim Kamate Fund	000 Leke	714,777	1,152,920	1,152,920	1,152,920	1,152,920
	Privat Riskedulim	000 Leke	28,747	76,115	76,115	76,115	76,115
	Reduktim Kamate	000 Leke	346,841	463,032	549,392	796,358	875,136
	Me Keste	000 Leke	2,937,291	2,940,822	3,481,468	4,322,962	5,239,523
	JO FAMILJARE		000 Leke	4,028,021	4,633,257	5,260,066	6,348,526
Grand Total		000 Leke	24,508,900	26,692,578	28,611,292	30,549,535	51,227,319

6. Analiza e kërkesë – ankesave të depozituara dhe zgjedhshmëria e tyre

Gjatë 9-mujorit 2020 janë depozituar rreth 101 mijë kërkesa – ankesa nga të cilat peshën kryesore të ankesave e zë për ndryshim i te dhënave te kontratës 40.0%, ankesa për faturim në masën 31%,

ankesat për ndryshim matesish në masën 25.0%, për cilësi shërbimi 2.3% dhe ankesa për kreditime 1.1%.

Gjatë të njëjtës periudhë, janë zgjidhur rreth 95 mijë ankesa – kërkesa të depozituara nga të cilat rreth 28 mijë i përkasin çështjeve të faturimit ose rreth (30.0%), nga ato të ndryshimit të të dhënave të kontratave në masën 38%, për ndryshime matësash 31% , ankesa për kreditime në masën 0.7%, si dhe për cilësi shërbimi 0.4%.

Mesatarja e ankesave mujore ndaj numrit total të faturave të emetuara është në nivelin < 0.3%.

Me anë të nismave të ndërmarra në favor të klientëve gjatë 9- mujorit 2020 janë zgjidhur rreth 28 mijë ankesa për faturim, duke përmirësuar cilësinë e shërbimit ndaj klientëve dhe duke rritur cilesinë e faturimit.

Ankesat e faturimit mbi totalin e faturave të emetuara

Muaji	Nr. Faturave të emetuara me konsum	Të ardhura	Të zgjidhura	% mbi totalin e faturave te ardhura	% mbi totalin e faturave te zgjidhura
Janar	976,930	3,394	1,804	0.35%	0.18%
Shkurt	975,096	3,225	2,353	0.33%	0.24%
Mars	972,270	1,872	1,475	0.19%	0.15%
Prill	984,207	4,229	3,486	0.43%	0.35%
Maj	958,550	4,246	3,106	0.44%	0.32%

Adresa : Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

Qershor	975,469	4,050	4,478	0.42%	0.46%
Korrik	998,347	3,422	4,440	0.34%	0.44%
Gusht	1,009,119	3,543	3,360	0.35%	0.33%
Shtator	995,176	3,631	3,929	0.36%	0.39%
TOTALI 9-mujori	11,830,692	31,612	28,431	0.27%	0.24%

II. PARASHIKIMI I KËRKESËS PËR ENERGJI

1.1 Të Dhënat dhe Metodologjia Bazë

Të dhënat historike të përdorura në parashikimin e energjisë totale në rrjetin e shpërndarjes dhe konsumit të energjisë për të gjithë konsumatorët e OSHEE sh.a janë marrë nga:

- Bilanci Energjistik për periudhën Janar 2007-Tetor 2020.
- Strukturat e Shitjes për periudhën Janar 2009–Tetor 2020.
- Të dhënat nga mbi kërkesen për energji elektrike të konsumatorëve fundorë, duke marrë parasysh infrastrukturën e nevojshme që krijon OSSH ndaj klientëve për implementimin e tregut të liberalizuar të energjisë sipas kategorive të ndryshme të lidhur në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2020 deri 2025. Parashikimi OSSH i miratuar edhe nga shoqëritë bija të OSHEE Group me etapat dhe supozimet si më poshtë:

#	Etapat
1	Duke qenë se OST përfundon projektin e paisjes me matje në distancë për të gjithë përdoruesit e rrjetit të OSSH të lidhur në TM dhe matje TM (në kuadrin e komponentes të tretë të PRP) në qershor 2021, kemi konsideruar 60% të përdoruesve lidhur&matur në TM 20 kv në Zonen Urbane do të kalojnë në treg të lirë përgjate gjysmës së dytë të 2021 (prandaj kane efekt 50%).
2	Në fund të vitit 2022, OSSH krijon infrastrukturën e plotë për dalje në treg të lirë të çdo përdoruesi të lidhur&matur në TM. Në këto kushte, parashikojmë të kalojnë në treg të lirë 20 kV tërësisht dhe 80% e 10 kV dhe 65% e 6 kV të Zonës Urbane.
3	Në fund të vitit 2023, OSSH krijon infrastrukturën për përdoruesit e lidhur në TU 0.4 kV të furnizuar nga fidera 20 kv për të dalë në treg të lirë. Në këto kushte, parashikojme të kalojnë në treg të lirë përveç atyre të mbetur të lidhur&matur në TM edhe 60% të përdoruesve të segmenteve Familjar dhe Tregtar.
4	Në fund të vitit 2024, OSSH krijon infrastrukturën për përdoruesit e lidhur në TU 0.4 kV të furnizuar nga fidera 10/6 kv për të dalë në treg të lirë. Në këto kushte, parashikojmë të


Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

	kalojnë në treg të lirë përveç atyre të mbetur të lidhur në TU 0.4 kV dhe furnizuar nga fidera 20 kV, edhe perdoruesit e segmentit Familjar dhe Tregtar të Zonave Urbane.
5	Në fund të vitit 2025, do të kalojë edhe pjesa e mbetur e konsumatorëve të lidhur në TU 0.4 kV të furnizuar nga fidera 10/6 kv (zonat Rurale).

1.2 Parashikimi i Energjisë së shitur për FSHU sh.a

Duke supozuar vazhdimin e sjelljes së konsumatorëve në mënyrë të ngjashme me konsumin historik të viteve të mëparshme, modeli i përdorur për parashikim është bazuar në trend dhe sezonalitet.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet trendi i Energjisë Elektrike së Shitur nga FSHU për periudhën 2016 – 2021:



1.3 Parashikimi i shitjeve të FSHU në nivel tensioni

Parashikimi i shitjeve në nivel tensioni i klientëve të FSHU për vitin 2021 paraqitet në tabelën që vijon:

Niveli i Tensionit	Lloji Tensioni	Energji e shitur FSHU
TM	35 Kv	22,599
TM	20 Kv	97,476
TM	10 Kv	69,591
TM	6 Kv	284,249

FSHU.sh.a

TU	0.4 kv Jo-Familjar	1,577,746
TU	0.4 kv Familjar	3,076,173
TOTAL		5,127,835

Sipas planit një pjesë e madhe e klientëve të FSHU në nivelin 20 kv për rret 134.4 Gwh do të largohen për tu furnizuar në Tregun e Lirë ashtu si dhe një pjesë tjetër e klientëve që furnizohen akoma nga FSHU në nivelin 35 kv.

1.4 Parashikimi Arkëtimeve

Arkëtimet gjithsej ku përfshihen respektivisht:

- arkëtimet nga faturat e emetuara gjatë 2021.
- arkëtimet nga faturat debitore (detyrime të prapambetura).
- arkëtimet nga vlera e kamatë vonesës.
- arkëtimet nga këstet e AKM-ve.

pritet të arrijnë në vlerën **63,765 Milion Lekë**

Norma e Arkëtimit për faturë (pa përfshirë vlerën e kamatëvonësës), parashikohet të shkojë në masën 95 % dhe parashikohet të arrijë vlerën 60,523,761,993 lekë.

Norma Total e Arkëtimit (duke përfshirë dhe vlerën e kamatë vonesës si dhe këstet e AKM-ve), parashikohet të jetë në masën 95%, në përputhje me Planin e Rimëkëmbjes.

Specifikisht e ndarë sipas kategorive është paraqitur në tabelën e mëposhtme :

ARKËTIMET PËR FATURË

Kategoria	Total 2018
Familjarë	30,282,320,086
Privatë	22,214,278,019
Buxhetorë	3,489,300,286
Jo-Buxhetorë	4,537,863,602
Total	60,523,761,993

ARKËTIMET PËR KAMATË

957,695,450

ARKËTIMET PËR AKM**2,284,502,311****GJITHSEJ****63,765,959,754**

1.5 Strategjia e përmirësimit të shërbimit ndaj klientit

Në kuadër të përpjekjeve për përmirësimin e shërbimit të klientit FSHU ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm që lidhen me:

- Përditësimin e të dhënave të konsumatorëve.
- Rritjen e transparencës gjate procesit të leximit - rileximeve duke përfshire anomalitë, të dyshimtat.
- Riorganizimin e shërbimit të klientit duke kaluar përgjegjësinë e cilësisë së shërbimit në zonën e shërbimit, duke krijuar ambientin për vetëm “One Stop Shop” dhe reduktimin e kohës se pritjes nëpër zyrat e OSHEE'së.
- “Front desk” ku çdo konsumator mund të paraqitet në zyrat qendrore OSHEE dhe të marrë zgjidhje për kërkesë-ankesën e tij.
- Reduktimin e kohës së përgjigjes ndaj konsumatorit për ankesa kërkesa dhe lehtësimin e procedurave operacionale (dhënie fuqie autorizimi në nivele rajonale dhe agjencie).
- Riorganizimin e roleve dhe funksioneve të monitorimit dhe mbikqyrjes së marrëdhënies me klientin në qendër me qëllim rritjen e kapaciteteve të stafit në shërbim në gjithë territorin dhe evidentimin në kohën e duhur të çështjeve të cilësisë dhe çështjeve teknike.
- Prezantimin e teknologjive të informacionit për ndjekjen e ecurisë së kërkesave dhe ankesave dhe kontrollin e afateve të përgjigjeve dhe llojet e përgjigjeve.
- Krijimin e qendrave të trajtimit të ankesave për faturim në mënyrë që të sigurohet arritja e cilësisë së shërbimit të lexim/faturimit dhe evidentimin në kohë të çështjeve specifike.
- Pranimin të shërbimit të klientit me qëllim komunikimin e identitetit dhe organizimin e ri të kompanisë.

III. SHPENZIMET PËR BLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE

3.1 Shpenzime për blerjen e energjisë për klientë të FSHU.

Sipas parashikimit FSHU do të shesë 5,127 Gwh gjatë vitit 2021 me një rritje prej 0,8% në krahasim me vitin 2020 me një kosto prej 15,112 milion Lekë ose rreth 2.4 miliard Lekë më të ulët se ajo e vitit që po mbyllet.

Të dhëna të detajuara lidhur me sasisë, çmimet dhe shpenzimet e parashikuara paraqiten në tabelën që vijon:

			2020	2021
			FSHU	FSHU
	Energji Gjithsej	Kwh	5,084,375	5,127,835
Sasi	Nga KESH	Kwh	3,051,405	3,950,000
	Nga HEC private (me çmim tregu nga FTL)	Kwh	249,767	640,656
	Nga Tregu i Lire	Kwh	1,783,202	537,179
Çmim	KESH	Lekë/Kwh	1.50	1.50
	Nga HEC private	Lekë/Kwh	6.36	7.80
	Nga Tregu I Lire	Lekë/Kwh	6.36	7.80
Lekë	KESH	Lekë	4,577,108	5,925,000
	Nga HEC private (me çmim tregu nga FTL)	Lekë	1,589,519	4,997,114
	Nga Tregu i Lire	Lekë	11,348,297	4,189,996
Kosto Totale		Lekë	17,514,925	15,112,110

Çmimi mesatar

3.4	2.9
------------	------------

Energjia e planifikuar për shitje në FSHU do të sigurohet nga furnizimi sipas këtyre burimeve:

- KESH i cili parashikohet të furnizojë sasinë prej 3,950 Gwh bazuar në parashikimet shumëvjeçare të prodhimit. Çmimi i blerjes nga KESH parashikohet të mbetet i pandryshuar për 1.5 Lekë/Kwh.
- Tregu i Lire nga i cili nëpërmjet FTL parashikohet të blihet rreth 1,783 Gwh me çmim mesatar 7.8 Lekë/Kwh.
- Energji nga HEC-et private si tepricë e energjisë së prodhuar dhe të blerë nga FTL me nevojat e OSSH për mbulimin e humbjeve për rreth 250 Gwh. Kjo energji do të shitet FSHU me çmimin e tregut pavarësisht çmimit të blerjes nga HEC-et.

Shpenzimet gjithsej për blerjen e energjisë për klientë të FSHU gjatë vitit 2021 parashikohen 15,112 milion Lekë. Çmimi mesatar i blerjes së energjisë parashikohet të ulët nga 3.4 Lekë/Kwh në vitin 2020 në 2.9 Lekë/Kwh në vitin 2021.

3.2 Shpenzime për transmetimin, shpërndarjen dhe disbalancat.

Shpenzimet për transmetimin, shpërndarjen dhe disbalancat paraqiten në tabelën më poshtë:

Zëri	2020	2021
Kosto e transmetimit	3,813,281	3,845,876
Disbalanca	218,125	229,032

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

Tarifa e Shpërndarjes	30,897,993	30,641,242
-----------------------	------------	------------

Tarifa e transmetimit për vitin 2021 është supozuar e pandryshuar nga ajo e vitit në vazhdim 2020 për 0.75 Lekë/Kwh.

Kosto e disbalancave është përlogaritur bazuar në kostot e ndara për vitin 2020 dhe kostot historike.

Tarifa e shpërndarjes është ajo e dalë nga përlogaritjet e kësaj kosotje për njësi transmetimi sikurse në aplikimin e shoqërisë së shpërndarjes së energjisë elektrike, përkatësisht 6.08 Lekë/Kwh për vitin 2020 dhe 5.98 Lekë/Kwh për vitin 2021.

IV. PËRLOGARITJA E SHPENZIMEVE OPERATIVE (OPEX)

4.1 Përmbledhje për shpenzimet operative

Përlogaritja e Shpenzimeve Operative për vitin 2021 u mbështet në informacionin e shpenzimeve historike sipas zërave dhe parashikimin e nevojave të vitit 2021 në një process pjesmarrje të gjerë të njësive sipas strukturës organizative të FSHU i cili do të aprovohet së shpejti nga Këshilli Mbikqyrës.

Përlogaritja e shpenzimeve operative u bazua në parashikimin për vitin 2020 mbi bazën e shpenzimeve të 10 muorit si dhe në parashikimet e shtesave dhe paksimeve të mundëshme për vitit 2021 si rezultat i ndryshimeve organizative të shoqërisë duke marrë parasysh edhe rritjen inflative të parashikuar për 3% të çmimeve të materialeve dhe shërbimeve.

Parashikimi i shpenzimeve operative për vitin 2020 dhe plani i shpenzimeve për vitin 2020 janë paraqitur në tabelën që vijon:

OSHEE OPEX (000 / Lekë)	2020	2021
	<i>Parashikim</i>	<i>Plan</i>
Shpenzime materiale dhe konsumi	72,232	74,399
Shpenzime për personelin	991,091	1,000,385
Mirembajtje	500	515
Penalitete dhe gjoba	-	-
Sherbime Korporate	321,807	331,461
Maredhenie me Publikun dhe Marketing	1,262	1,300
Qera	130,000	133,900

Sherbime Postare dhe Komunikimi	894,731	921,573
Shpenzime Teknologjia e informacionit	20,000	20,600
Shpenzime Ligjore	30,168	31,073
Konsulence dhe Auditim	50,000	51,500
Te tjera	335,365	345,426
Totali i Shpenzimeve Operative	2,847,156	2,912,132

4.2 Shpenzime materiale dhe konsumi.

Shpenzimet për kancelari zënë peshën kryesore në këtë zë të shpenzimeve me rreth 72% shpenzime që kryesisht bëhen në qendrat e kujdesit ndaj klientit dhe për të rritur shpejtësinë e shërbimit dhe transparencën. Shoqëria ka bërë përpjekje të vazhdueshme për kontrollin dhe uljen e shpenzimeve në këtë zë duke tentuar normimin e shpenzimeve për aktivitetet bazë me të cilat lidhen këto shpenzime. Shpenzimet për veshje dhe vegla pune përbëjnë gjithashtu rreth 21% të totalit të shpenzimeve materiale. OSHEE ka tashmë standarte dhe normim të shpenzimeve për rrobat e dhe veglat e punës të cilat jo vetëm përmirësojnë paraqitjen dhe komunikimin me klientët por janë edhe domosdoshmëri e sigurimit teknik të punonjësve. Parashikimi për shpenzimet materiale bazohet në kostot e pritshme 2020 dhe inflacionin 2021.

4.3 Shpenzime për personelin

Ristrukturimi i skemës organizative të Shoqërisë pritet të ruajë të njëjtin nivel të shpenzimeve të personelit duke u shoqëruar më një rritje të lehtë inflative prej 0.94 % në vitin 2021 në krahasim me vitin 2020.

4.4 Penalitete dhe Gjoha.

Shpenzimet për penalitete dhe gjoha vazhdojnë të jenë të larta edhe gjatë vitit 2020 me një parashikim prej rreth 1miliard Lekë, kryesisht si pasojë e detyrimeve ligjore që lidhen me periudha e administrimeve të viteve të mëparshme. Për vitin 2021 këto shpenzime parashikohet të jenë rreth 200 milion Lekë megjithatë ato nuk janë llogaritur në tarifë në zbatim të metodologjisë së llogaritjes së tarifave.

4.5 Shpenzime për shërbime kooperative

Shërbimet që do të kryhen nga shoqëria OSHEE mëmë për FSHU dhe kostot e këtyre shërbimeve gjatë vitit 2021 parashikohet të jenë si në tabelën që vijon:

000/Lekë

Përshkrimi	FSHU
<i>Shërbime Marrëdhënie me publikun</i>	4,936
<i>Shërbime Prokurimi dhe Shërbime Mbështetëse</i>	136,779
<i>Shërbime Teknologji Informacioni</i>	88,641
<i>Shërbime Menaxhim strategjik , Qeverisje korporative</i>	1,717
<i>Shërbime Finance, Kontroll dhe menaxhim të dhënash</i>	34,335
<i>Shërbime Menaxhimi i Burimeve Njerëzore</i>	40,472
<i>Shërbime ligjore</i>	14,926
TOTAL	321,807

4.6 Marrëdhënie me Publikun

Shërbimet për marrëdhënie me publikun do të mbulohen kryesisht nga shoqëria mëmë OSHEE ndërsa vlera në shpenzimet operacionale planifikohet për një pjesë të vogël të shpenzimeve direkte që lidhet me këtë zë.

4.7 Shpenzime për Qera

Shpenzimet për qera në vitin 2021 do të kenë rritje vetëm në kufijtë e inflacionit në krahasim me shpenzimet e pritshme 2020. Nevojat për shërbime të drejtpërdrejta tek klientët do të përballohen nga qendrat ekzistuese të kujdesit të cilat në pjesën më të madhe janë objekte të marra me qera.

4.8 Shërbime Postare dhe Komunikimi

Këto shpenzime lidhen kryesisht me shpërndarjen mujore të faturës për klientët dhe me tarifat për arkëtimin e faturave nga Posta Shqiptare. Planifikimi i shpenzimeve për këto zëra u mbështet kryesisht në koston historike në realizimin dhe buxhetin 2020, në shërbimet e reja për komunikim të drejtpërdrejtë me klientët me SMS si dhe rritjen e mundshme për shkak të inflacionit.

4.9 Shpenzime të Teknologjisë së Informacionit

Shërbimet për teknologjinë e informacionit do të mbulohen kryesisht nga shoqëria mëmë OSHEE, e cila zotëron pjesën më të madhe të aseteve të kësaj teknologjie në përdorim të të gjitha shoqërive të grupit, ndërsa vlera në shpenzimet operacionale planifikohet për një pjesë të vogël të shpenzimeve direkte që lidhet me këtë zë.

4.10 Shpenzime Ligjore

Shërbimet ligjore do të mbulohen kryesisht nga shoqëria mëmë OSHEE ndërsa vlera në shpenzimet operacionale planifikohet për një pjesë të vogël të shpenzimeve direkte që lidhet me këtë zë.

4.11 Konsulencë dhe Auditim

Shpenzimet për konsulencë dhe auditim janë parashikuar të mbulojnë detyrimin ligjor për auditim të veprimtarisë së shoqërisë si edhe nevojat për konsulencë vendase dhe të huaj, të cilat në kushtet e menaxhimit të pavarur janë të domosdoshme sidomos gjatë viteve të para të aktivitetit.

4.12 Shpenzime të tjera.

Shërbimi i sigurimit të transportit të mjeteve monetare dhe godinave dhe ambjenteve të OSSH e shtrirë në të gjithë territorin e vendit përbën vlerë më të madhe të shpenzimeve të tjera të shoqërisë, ku një pjesë të rëndësishme e zënë edhe shpenzime për projekte të veçanta të shoqërisë që kryhen me ekspertizë të shoqërive të tjera vendase dhe të huaja. Në këtë zë është përfshirë edhe primi i sigurimit për sigurimin nga aksidentet dhe kushtet e fatkeqsive natyrore.

V. AMORTIZIMI, MARZHI I APLIKUAR DHE KOSTO E KAPITALIT TË PUNËS

5.1 Amortizimi

Vlera e shpenzimeve të amortizimit është llogaritur për atë pjesë të asetëve që i kanë kaluar FSHU gjatë procesit të ndarjes së shoqërisë. Vlera e amortizimit për vitin 2021 është bazuar në parashikimet për vitin 2020 dhe investimeve të vogla për asete materiale dhe jo-materiale.

5.2 Marzhi

Bazuar në metodologjinë e llogaritjes së çmimit marzhi është përllogaritur 3% mbi koston e energjisë së shitur.

5.3 Kosto e lejuar e kapitalit të punës

Kapitali i punës është llogaritur sa 1/12 e shpenzimeve për energjinë e blerë, shpenzimet e trasmetimit, shpenzimet e shpërndarjes dhe shpenzimeve operative. Noma e financimit të kapitalit të punës është konsideruar norma e interesit të borxhit të ri brenda grupit OSHEE, e cila për vitin 2021 është llogaritur 4.17% nga 5% që ishte për vitin 2020.

Kosto e lejuar e kapitalit të punës është produkti ndërmjet kapitalit të punës dhe normës së financimit të kapitalit të punës dhe është llogaritur 182.4 milion Lekë për vitin 2021.

5.4 Kompensimi i borxhit të keq

Pavarësisht mosarritjes së objektivit për të pasur normën e arkëtimit 95% gjatë vitit 2020, për vitin 2021 borxhi I keq është llogaritur në 5% bazuar në Planin e Konsolidimit Financiar që norma e arkëtimit në shitjen e energjisë të jetë 95%.

VI. E ARDHURA E KËRKUAR PËR FURNIZUESIN UNIVERSAL

Nga përlllogaritjet në tabelën më poshtë rezulton se totali i të ardhurave të kërkuara për Furnizuesin Universal në vitin 2021 është 56,192 milion Lekë me një ulje prej rreth 2.7 miliard Lekë në krahasim me vitin 2020. Ulja e kostos planifikimit të energjisë së blerë për klientët e FSHU si rrjedhojë e furnizimit më të mirë nga KESH është faktori kryesor i kësaj uljeje si në tabelën më poshtë:

	Zëri	2020	2021
E	Kosto e Energjise se shitur nga FPSH	17,514,925	15,112,110
TF	Kosto e transmetimit	3,813,281	3,845,876
D	Disbalanca	218,125	229,032
DUOS	Tarifa e Shperndarjes	30,897,993	30,641,242
OM	Shpenzime Operative	2,847,156	2,902,478
	<i>Shpenzime materiale dhe konsumi</i>	72,232	74,399
	<i>Shpenzime për personelin</i>	991,091	1,000,385
	<i>Mirembajtje</i>	500	515
	<i>Penalitetet dhe gjoba</i>		
	<i>Sherbime Korporate</i>	321,807	321,807
	<i>Maredhenie me Publikun dhe Marketing</i>	1,262	1,300
	<i>Qera</i>	130,000	133,900
	<i>Sherbime Postare dhe Komunikimi</i>	894,731	921,573
	<i>Shpenzime Teknologjia e informacionit</i>	20,000	20,600
	<i>Shpenzime Ligjore</i>	30,168	31,073
	<i>Konsulence dhe Auditim</i>	50,000	51,500
	<i>Te tjera</i>	335,365	345,426
DA	Amortizimi	80,702	88,772
RM	Marzhi	525,448	453,363
WCA	Kosto e lejuar e kapitalit te punes	229,492	182,438
WC	<i>Kapitali I punes</i>	4,589,446	4,375,142
WCC	<i>Kosto e Financimit te Kapitalit te punes</i>	5.00%	4.17%
BD	Kompensimi i Borxhit i Keq	2,723,904	2,736,921
AXH	Korrigjim i te Ardhurave		
	Totali i të Ardhurave të Kërkuara	58,851,026	56,192,232

Ulja në totalin e të ardhurave të kërkuara sjell edhe uljen e çmimi mesatare të shitjes së energjisë elektrike si në tabelën që vijon:

Zëri	2020	2021
Totali i te Ardhurave te Kerkuara	58,851,026	56,192,232
Energji e shitur MWH	5,084,375	5,127,835
Çmimi mesatar i shitjes Lekë/KW	11.57	10.96

VII. PROPOZIM PËR TARIFË MESATARE TË SHITJES NGA OSHEE

Në përmbledhje të studimit të tarifës për shpërndarjen dhe shitjen sa më lart, duke pasur parasysh analizën e detajuar sipas treguesve të projektuar, OSHEE lidhur me tarifat dhe çmimet e shitjes së Energjisë Elektrike në vitin 2021 propozon sa vijon:

Në përfundim:

Meqenëse tarifa mesatare e përlogaritur sa më lart për vitin 2021 është thujse e njëjtë me atë të vitit 2015, duke u mbështetur në përvojën shumë positive të arritjeve të periudhës 2015-2017 shoqëria propozon që:

- a) Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike si dhe çmimet e detajuara sipas vendimit të ERE Nr148 datë 25.12.2014, të mos ndryshojnë.*
- b) Çmimi i shitjes për Konsumatorët e lidhur në TM dhe me matës në TU sipas vendimit të ERE Nr128 datë 29.07.2016, të mos ndryshojnë.*
- c) Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për kategorinë Objekte Kult/Bashkësi Fetare sipas vendimit të ERE Nr. 53 datë 06.04.2017, të mos ndryshojnë.*